**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

**Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional**

# STANDARDI I PROFESIONIT

# Instalues i Ngrohjes, Klimatizimit dhe Ujësjellësit

## Sektori: Punonjësit e zejes dhe profesioneve të ngjashme

**Kodi:** (ISCO 08), **7126 - Hidraulikët (ujësjellësit) dhe punëtorët për vendosjen e tubave** sipas (KPK 08, Prishtinë 2016)

Versioni në gjuhen Angleze (7126 Plumbers and Pipe Fitters), ISCO 08, ILO

## Data e aprovimit:

**Ky standard i profesionit është zhvilluar me mbështetjen e Projektit KSV/020 "Mbështetje për Reformën e Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Kosovë", i menaxhuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë - MASHT.**

**Ekipi për zhvillimin e Standardit të Profesionit: Instalues i Ngrohjes e Klimatizimit dhe Ujësjellësit**

**Moderator:** Ramë Likaj

**Koordinatorë i ekipit:** Inxh. dip. mak. Lulzim KRRABAJ

**Anëtaret e grupit:** Inxh hidro. Krenar Xh. XHAFERI, Inxh. dip mak. Arben AVDIU

## REFERENCAT:

Ky material është përpiluar duke u bazuar dhe referuar ne këto burime të informacionit:

1. Analiza e punës me metodën Dacum për instalues i ngrohjes dhe klimatizimit – SWISSCONTACT-2000.

2. Analiza e punës me metodën Dacum për instalues ujësjellësit dhe kanalizimit – SWISSCONTACT-2000.

3. Standardi i profesionit për Instalime te ngrohjes qendrore KOSVET V – SWISSCONTACT-2010.

4. Standardi i profesionit për Instalime te ujësjellësit dhe kanalizimit KOSVET V – SWISSCONTACT- 2010.

5. Стандард на занимање-
Монтер за водоводна и санитарна инсталација/Монтер за топловодна инсталација financuar nga EU-USAID dhe BRITICH COUNCIL-2012.

6. Konsulta me ekspert nga ndërmarrje që merren me instalimeve të ngrohjes dhe klimatizimit 2019.

7.Konsulta me ekspert nga nderrmarje që merren me instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit 2019.

**Vërejtje: Ky standard profesioni sipas klasifikimit të profesioneve në Kosovë ISCO 88, lidhet madje me rreth 70% (sipas një analize të ekspertëve tonë) edhe me disa profesione të klasifikuara diku tjetër si:**

**Kodi: (ISCO 08), 7127 - Mekanikët për kondicioner dhe pajisje ftohëse** sipas (KPK 08, Prishtinë 2016, Versioni në gjuhen Angleze (7127 Air Conditioning and Refrigeration Mechanics), ISCO 08, ILO

**Përshkrimi i profesionit:**

Nxënësi që merr arsimin profesional sipas një modeli të standardizuar kryen në mënyrë të pavarur instalime të sistemeve të ngrohjes e klimatizimit dhe ujësjellësit e kanalizimit me theks të veçantë të sistemeve të ngrohjes e klimatizimit dhe ujësjellësit e kanalizimit për të ngrohur dhe ftohur si dhe instalon sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit të objekteve individuale dhe atyre shoqërore, si dhe aftësohet që në mbikëqyrje të zbaton projekte edhe më të mëdha m**ë** komplekse të instalimeve . Në përgjithësi nxënësi:

- *Instalon linja të tubacionit të sistemeve të ngrohjes, klimatizimit, ujësjellësit e kanalizimit me elementet përbërëse të tyre përkatësisht armaturave matëse siguruese dhe kontrolluese.*
- *Instalon Kaldaja të lëndës djegëse të ngurtë, lëngët dhe të gazit dhe trupa ngrohës (radiator).*
- *Monton depozita të ngrohjes dhe ujësjellësit, e pompave, pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri.*
- *Instalon trupa ngrohës dhe pajisjet hidrosanitare.*
- *Teston, regjistron dhe vë në funksion sistemet e ngrohjes, ftohjes, ujësjellësit dhe kanalizimit.*
- *Respekton masat mbrojtëse dhe të sigurisë në vendin e punës.*
- *I dorëzon klientit sistemin e instaluar dhe i jep atij shpjegimet dhe udhëzimet e nevojshme të përdorimit.*
- *Mbanë në funksion sistemet e ngrohjes, ftohjes, ujësjellësit dhe kanalizimit dhe sistemet e ngjashme si dhe*
- *Inspekton, mirëmban dhe riparon sistemet e ngrohjes.*

Përveç aftësive dhe njohurive teknike me të cilët nxënësi do ti plotësoj kompetencat profesionale, aji/ajo përmes projekteve të nxënit, do të pajiset edhe me kompetencat kryesore personale dhe sociale :

- *Të kërkojnë, vlerësojnë dhe përdorin burime dhe dokumentacione teknike,*
- *Të shpjegojnë dhe hartojnë udhëzime mbi funksionimin dhe të bëjnë prezantime teknike me teknika të ndryshme,*
- *Të zbatojnë planifikime detyrash dhe punësh, të organizohen dhe punojnë në grup si dhe të komunikojnë siç duhet me klientin*
- *Të përdor teknologjinë e informimit dhe komunikimit për qëllime profesionale,dhe t'i zbaton parimet kryesore të menaxhimit të cilësisë.*

| Nr. | Funksioni | Përshkrimi i funksionit |
|---|---|---|
| 1 | Planifikimi i instalimit të ngrohjes e klimatizimit dhe ujësjellësit e kanalizimit | Ky funksion ka të bëjë me :<br>• punët përgatitore për të plotësuar kërkesat e instalimit të sistemeve dhe komponentëve,<br>• analizimi i projektit të objektit ku do të kryet instalimi dhe përgatitjen e skicës së punës,<br>• planifikimin e dinamikes së punës (caktimin e detyrave të punës, kontrollin e përmbushjes së detyrave të punës brenda afatit të caktuar),<br>• përzgjedhjen e materialeve të duhura për punë,<br>• mirëmbajtjen e veglave të punës,<br>• sigurinë gjatë procesit të punës dhe ruajtjen e mjedis. |
| 2 | Llogaritja për kryerjen e punimeve në instalimin e ngrohjes e klimatizimit dhe ujësjellësit e kanalizimit | Ky funksion ka të bëjë me:<br>• kalkulimin e shpenzimeve të materialit,<br>• kalkulimin e çmimit të shërbimit,<br>• kalkulimin e çmimit të përgjithshëm të instalimit,<br>• përgatitjen e ofertës për klientin,<br>• sigurinë gjatë procesit të punës dhe ruajtjen e mjedis. |
| 3 | Përgatitja e gypave për instalimin e rrjetit të ngrohjes e klimatizimit dhe ujësjellësit e kanalizimit. | Ky funksion ka të bëjë me;<br>• përzgjedhjen e veglave, pajisjeve për punimet me gypa: të zinkuar, bakrit, çelikut, aluplasti dhe plastikës,<br>• përzgjedhjen e materialeve për punime në gypa,<br>• kryerjen e punimeve (prerja, lëmimi, ngjitja dhe saldimi),<br>• sigurinë gjatë procesit të punës dhe ruajtjen e mjedis. |
| 4 | Kryerja e punimeve për hapjen e kanaleve dhe vrimave ne rrjetin e ngrohjes e klimatizimit dhe ujësjellësit e kanalizimit | Ky funksion ka të bëjë me:<br>• përzgjedhjen e resurseve për metodat e punës,<br>• kontrollin e kualitetit të punës,<br>• hapjen e kanaleve dhe vrimave,<br>• konsultimin me personat adekuat (përgjegjësit),<br>• respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes se mjedisi. |
| 5 | Kryerja e montimit te gypave dhe armaturave të ngrohjes e klimatizimit. | Ky funksion ka të bëjë me :<br>• përzgjedhjen e resurseve për metodat e punës,<br>• kryerjen e punimeve për montimin e gypave te bakrit, çelikut dhe plastikës,<br>• montimi i gypave për ventilim, |

| | | |
|---|---|---|
| | | • montimin e armaturave,<br>• kontrollimin e rrjetit dhe funksionalitetin e tij,<br>• respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes se mjedisi |
| 6 | Kryerja e montimit te gypave dhe armaturave të ujësjellësit e kanalizimit. | Ky funksion ka të bëjë me:<br>• përzgjedhjen e resurseve për metodat e punës,<br>• kryerjen e punimeve për montimin e gypave të çelikut, plastikës,<br>• montimin e gypave për drenazhimit,<br>• montimin e armaturave,<br>• kontrollimin e rrjetit dhe funksionalitetin e tij,<br>• respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes se mjedisi. |
| 7 | Montimi i trupave ngrohës | Ky funksion ka të bëjë me:<br>• përzgjedhjen e resurseve për metodën e punës,<br>• përgatitjen dhe montimin e llojeve të ndryshme të trupave ngrohës,<br>• verifikimin e funksionalitetit të pajisjeve të instaluara,<br>• respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes se mjedisi. |
| 8 | Montimi i pajisjeve hidrosanitare | Ky funksion ka të bëjë me:<br>• përzgjedhjen e resurseve për metodën e punës,<br>• instalimin e pajisjeve sanitare dhe elementeve tjera përcjellëse,<br>• verifikimin e funksionalitetit të pajisjeve të instaluara,<br>• respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisi. |
| 9 | Kryen punime në hapësirën e kaldatore (bojler qendror i kombinuar për ujë sanitar, depozitat e ujësjellësit, montimin e pompave, pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri). | Ky funksion ka të bëjë me:<br>• përzgjedhjen e resurseve për metodën e punës,<br>• punimet që duhen të kryhen në hapësirën e Kaldatores,<br>• termoizolimin e gypave të INKUK,<br>• montimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike,<br>• lidhjen e kaldajës me rezervuarin e lendes djegëse,<br>• instalimin e pompave, depozitave,bojlerit të kombinuar,<br>• montimin e pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri,<br>• verifikimin e funksionalitetit të stabilimenteve të instaluara,<br>• respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes se mjedisi. |

| | | |
|---|---|---|
| 10 | Instalimi i ngrohjes nën dysheme. | Ky funksion ka të bëjë me:<br>• përgatitjen e objektit për fillimin e shtrimit të sistemit të ngrohjes nën dysheme,<br>• instalimin e rrjetit kryesor shpërndarës dhe kasetave shpërndarëse,<br>• shtrirjen e rrjetit vertikal si dhe pajisjet matëse siguruese dhe rregulluese,<br>• lidhjen e rrjetit vertikal me kolektor dhe kaldatore,<br>• testimin e rrjetit dhe përfundimi i punimeve,<br>• respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes se mjedisi. |
| 11 | Instalimi i sistemeve diellore për ngrohje qendrore dhe për ngrohjen e ujit sanitar. | Ky funksion ka të bëjë me:<br>• konstruktimin e mbajtësve, vendosjen e tyre në orientimin e duhur (juglindje),<br>• vendosjen dhe lidhjen e paneleve diellorë në konstruksion,<br>• lidhjen e rrjetit të paneleve diellore me akumuluesin dhe bojlerin qendrorë i cili përdoret për ngrohjen dhe ngrohjen e ujit sanitar,<br>• lidhjen e kontrollorit dhe sondave për kontrollimin e punës së sistemit diellorë,<br>• mbushjen e sistemit me glykol, lëshimi në punë i sistemit,<br>• respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes se mjedisi. |
| 12 | Montimi i split klimave(kondicionerëve të ajrit) | Ky funksion ka të bëjë me:<br>• parapërgatitjen për instalimin e Split klimave,<br>• montimin i njësisë së jashtme dhe njësisë së brendshme në mbajtës dhe instalimin e rrjetit gypor të kondicionerit,<br>• vakumimin e sistemit,<br>• kyçjen në rrjetin elektrik dhe startimi i pajisjes,<br>• kontrollimin përfundimtar,<br>• respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes se mjedisi. |

**Funksioni1: Planifikimi i instalimit**

Kjo funksion ka të bëjë me: Punët përgatitore për fillimin e instalimit të sistemeve dhe komponentëve të tij, analizën e objektit ku do të punohet, sjelljen e materialeve në vendet e punës, sjelljen e veglave të punës.

| **Aktivitetet kyçe**<br>**(+ rezultatet e punës)** | **Kriteret e përformancës** | **Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin** | **Shkathtësitë** | **Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor** |
|---|---|---|---|---|
| Punë përgatitore për të plotësuar kërkesat e instalimit të sistemeve dhe komponentëve. | Përzgjedh veglat, pajisjet për vendin e punës;<br>Përgatit veglat për punë;<br>Përgatit vendin për punë;<br>Vesh rrobat e punës;<br>Përcakton nevojat për fuqi punëtore; | Nxënësi /kandidati duhet të :<br>Shpjegon matjen, incizimin, detajet e instalimit, qëllimet e instalimit.<br>Vizaton një skicë instalimi.<br>Përdor dokumentacionin teknik.<br>Tregon standardet e gypave.<br>Përshkruan rregullat teknike për vendosjen e gypave.<br>Shpjegon elementet e ngrohjes qendrore.<br>Tregon rregullat për vendosjen e elementeve të ngrohjes qendrore .<br>Respekton masat mbrojtëse dhe sigurisë në punë | Aftësi për të vepruar në :<br>Përzgjedhjen adekuate të veglave dhe pajisjeve,<br>Përgatitjen e vendit të punës,<br>Leximin e projektit,<br>Përgatitjen e skicës së punës,<br>Specifikimin e materialit,<br>Mirëmbajtjen e veglave,<br>Zbatimin e masave e sigurisë në punë. | Puna në grup<br>Shkathtësi të mira në komunikim në gjuhën profesionale dhe zyrtare me klient për planin e instalimit. |
| Analizimi i projektit të objektit ku do të kryet instalimi dhe përgatitjen e skicës së punës. | Lexon projektin;<br>Shqyrton në detaje pozicionet që do të punohen;<br>Bën skicën ideore për fillimin e punimeve; | | | |
| Planifikimi i dinamikes së punës (caktimin e detyrave të punës, kontrollin e përmbushjes së detyrave të punës brenda afatit të caktuar). | Cakton detyrat e punës;<br>Përcakton afatet kohore për kryerjen e punëve;<br>Kontrollon përmbushjen e detyrave të punës brenda afatit të caktuar; | | | |
| Përzgjedhjen e materialeve të duhura për punë. | Përcakton llojet e materialeve për punë;<br>Materialet janë në përputhje me kërkesat e instalimit;<br>Kontrollon cilësinë e materialit; | | | |
| Mirëmbajtja e veglave të punës. | Evidention veglat, pajisjet të dëmtuara, zëvendësimi i tyre, riparimi; | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Pastron dhe lyen veglat pas çdo pune;<br>Sistemimin e veglave në vendet e caktuara; | | | |
| Sigurinë gjatë procesit të punës dhe ruajtjen e mjedis | Identifikon rreziqet e shëndetit;<br>Përdorë veshje dhe pajisje sigurimi të nevojshme për mbrojtjen nga rreziqet në përputhje me direktivën e mbrojtjes në punë;<br>Siguron hapësirën e punës;<br>Siguron pajisjet, veglat dhe materialet;<br>Kontribuon në evitimin e rreziqeve ndaj shëndetit;<br>Kontribuon në mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirën e punës; | | | |

**Kushtet e realizimit të funksionit:** Identifikimi i karakteristikave të punës për instaluesit (INKUK)**:** I referohen përgatitjes së skicës së vizatimit, leximit të dokumentacionit teknik, veglave për punë, përzgjedhjes së veglave, pajisjeve për vendin e punës, përgatitjes së vendit për punë, respektimit të normave dhe rregullave për ekzekutimin e INKUK, komunikimit në gjuhën e profesionit dhe atë zyrtare.

Planifikimi i dinamikës së punës i referohet : Detyrave të punës, afateve kohore për kryerjen e punëve, kontrollimit të përmbushjes së detyrave të punës brenda afatit të caktuar.

Mirëmban veglat e punës: I referohet mirëmbajtjes së veglave të punës në vendin e punës, (Pastrimi dhe lyerja e veglave pas çdo pune, evidentimi i veglave, pajisjeve të dëmtuara, zëvendësimi, riparimi).

Masat e mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit i referohet sigurimit të hapësirës se punës, sigurimit të pajisjeve, veglave dhe materialeve, mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirën e punës.

**Kërkesat e vlerësimit të funksionit:**

<u>Evidenca e performancës</u>: Evidenca se si kryhen aktivitetet, grumbullohen nëpërmjet vëzhgimit të kandidatit duke i bërë këto aktivitete (të përshkruara në funksion) në një situatë reale të punës. Kontrollimi i ambientit te punës /liste kontrolli, vlerësimi i instalimit – puna grupore, vlerësimi i produktit

<u>Evidenca e njohurive</u>: Test me shkrim, pyetje dhe përgjigje me gojë për të demonstruar që nxënësi i ka kuptuar kërkesat e punës dhe rregullat në marrëdhënie me funksionet e përshkruara më lartë. Bisedë profesionale – pyetje të shkurtra praktike.

**Funksioni 2: - Kryerja e llogarive për kryerjen e punimeve**

Kjo funksion ka të bëjë me : Kalkulimin e shpenzimit të materialit, kalkulimin e çmimit të shërbimit, kalkulimin e çmimit të përgjithshëm të instalimit.

| **Aktivitetet kyçe**<br>**(+ rezultatet e punës)** | **Kriteret e performancës** | **Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin** | **Shkathtësitë** | **Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor** |
|---|---|---|---|---|
| Kalkulimi i shpenzimit të materialit. | Përcakton sasinë, dimensionet dhe përmasat për materialet të INKUK;<br>Përcakton sasinë, dimensionet dhe përmasat e të gjithë materialeve; | Nxënësi /kandidati duhet të :<br>Shpjegon se si bëhen llogari të thjeshta ekonomike,<br>Përshkruan strukturën dhe llojet e shpenzimeve,<br>Tregon normativën e materialeve bazë dhe ndihmëse shpenzuese,<br>Tregon normativat kohore të punës.<br>Shpjegon masat mbrojtëse | Aftësi për të:<br>Llogaritur vëllimin e punimeve,<br>Llogaritur çmimin e shërbimeve,<br>Përgatitur ofertën klientit,<br>Respektuar masat mbrojtëse. | I përshtatshëm për punë ekipore,<br>Komunikativ,<br>Fleksibil,<br>Tolerant,<br>I arsyeshëm,<br>I vetëdijshëm për punën që kryen,<br>Njohja e gjuhëve të huaja. |
| Kalkulimi i çmimit te shërbimit. | Përcakton vëllimin e punimeve;<br>Përcakton çmimin e shërbimeve;<br>Përcakton vlerën për shpenzime të paparashikuar;<br>Përllogaritja e kohës së realizimit; | | | |
| Kalkulimi i çmimit të përgjithshëm të instalimit (Përgatitja e ofertës për klientin). | Përpilon listën e të gjithë materialeve, sasinë dhe çmimin e tyre;<br>Përcakton çmimin total të materialit për instalimin;<br>Përpilon paramasën dhe parallogaritë; | | | |
| Sigurinë gjatë procesit të punës dhe ruajtjen e mjedis. | Identifikon rreziqet e shëndetit;<br>Përdorë veshje korrekte dhe pajisje sigurimi të nevojshme për mbrojtjen nga rreziqet në përputhje me direktivën e mbrojtjes në punë;<br>Siguron hapësirën e punës;<br>Siguron pajisjet, veglat dhe materialet;<br>Kontribuon në evitimin e rreziqeve ndaj shëndetit;<br>Kontribuon në mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirën e punës; | | | |

**Kushtet e realizimit të funksionit:**

**Kryerja e llogarive për kryerjen e punimeve** i referohet : kalkulimit të çmimit të shërbimeve dhe çmimit të përgjithshme të instalimeve (Përpilimit të listës së të gjithë materialeve, sasinë dhe çmimin e tyre, përcaktimit të çmimit total të materialit për instalim).

**Kërkesat e vlerësimit të funksionit:**

<u>Evidenca e performancës</u>: Evidenca se si kryhen aktivitetet, grumbullohen nëpërmjet vëzhgimit të kandidatit duke i bërë këto aktivitete (të përshkruara në funksion) në një situatë reale të punës. Kontrollimi i ambientit te punës /liste kontrolli.

<u>Evidenca e njohurive</u> : Test me shkrim, pyetje dhe përgjigje me gojë për të demonstruar që nxënësi i ka kuptuar kërkesat e punës.

**Funksioni 3: - Përgatitja e gypave për instalimin e rrjetit të (Ngrohjes e Klimatizimit dhe Ujësjellësit e Kanalizimit).**

Kjo funksion ka të bëjë me : Përzgjedhja e resurseve për metodat e punës, përzgjedhja e materialeve për punime ne gypa, kryerja e punimeve në gypa, termoizolimin e gypave të ngrohjes, izolimin e gypave të ujësjellësit.

| **Aktivitetet kyçe**<br>**(+ rezultatet e punës)** | **Kriteret e performancës** | **Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin** | **Shkathtësitë** | **Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor** |
|---|---|---|---|---|
| Përzgjedhja e resurseve për metodat e punës. | Përzgjedh veglat dhe pajisje të sigurta të cilat plotësojnë kërkesat e sigurisë dhe shëndetit;<br>Punon në mënyrë të sigurt sipas rregullores dhe udhëzimeve zyrtare për sigurinë në punë dhe shëndetin;<br>Korrigjon masat gjatë procesit të punës në gypa;<br>Përgatit vendin për punë; | Nxënësi /kandidati duhet të :<br>Përshkruan specifikat e veglave,<br>Identifikon materialin e punës,<br>Identifikon veglat dhe pajisjet për punime në gypa<br>Tregon masat mbrojtëse të punës dhe sigurisë | Aftësi të:<br>Përzgjedhjes së pajisjet dhe veglat e punës,<br>Përdorimit të veglave dhe pajisjeve në varësi të kërkesave,<br>Kryerjes së punimeve (prerjen, lëmimin, ngjitje e saldimin) e gypave,<br>Kontrollimit dhe testimit të rrjetit të instaluar, | I përshtatshëm për punë ekipore,<br>Komunikativ,<br>Fleksibil,<br>Tolerant,<br>I arsyeshëm,<br>I vetëdijshëm për punën që kryen,<br>Njohja e gjuhëve të huaja. |
| Përzgjedhja e materialeve për punime në gypa. | Përzgjedh materiale adekuate të sigurta të cilat plotësojnë kërkesat për punë në gypa;<br>Përcakton llojet e materialeve për punë në përputhje me kërkesat e instalimit;<br>Kontrollon cilësinë e materialit; | | | |
| | Përzgjedh dhe përdorë veglat dhe pajisjet e punës;<br>Bën prerjen e gypave me instrumente që plotësojn kërkesat dhe standardet e kërkuara për prerje; | | | |

| **Aktivitetet kyçe**<br>**(+ rezultatet e punës)** | **Kriteret e performancës** | **Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin** | **Shkathtësitë** | **Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor** |
|---|---|---|---|---|
| Kryerja e punimeve (prerja, lëmimi, ngjitja, saldimi). | Lëmimi dhe pastrimin e sipërfaqeve të prera;<br>Lidh elementet e sistemit me ngjitje duke përdor metodat që përputhen me kërkesat e instalimit;<br>Lidh elementet e sistemit me saldim duke përdor metodat që përputhen me kërkesat e instalimit;<br>Korrigjon masat gjatë procesit të punimeve ne gypa aty ku është e nevojshme; | | Zbatimit të masave të sigurisë. | |
| Sigurinë gjatë procesit të punës dhe ruajtjen e mjedis. | Identifikon rreziqet e shëndetit;<br>Përdorë veshje korrekte dhe pajisje sigurimi të nevojshme për mbrojtjen nga rreziqet në përputhje me direktivën e mbrojtjes në punë;<br>Siguron hapësirën e punës;<br>Siguron pajisjet, veglat dhe materialet;<br>Kontribuon në evitimin e rreziqeve ndaj shëndetit;<br>Kontribuon në mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirën e punës; | | | |

**Kushtet e realizimit të funksionit:**

**Përgatitja e gypave për instalimin e rrjetit të (Ngrohjes e Klimatizimit dhe Ujësjellësit e Kanalizimit). I** referohet punimeve të cilat duhet të kryhen në përzgjedhjen e resurseve për metodat e punës në objektet private, përzgjedhja e materialeve, veglave dhe pajisjeve që i referohen punimeve ne gypa bakri, çeliku, plastikës etj. me prerje, lëmim, saldim, ngjitje si dhe respektimin e masave mbrojtëse.

**Veglat dhe pajisjet e punës** : metër, sharra e dorës, taletubi, flex elektrik dore, aparate saldim, ngjitje, veshje pune, syza, doreza pune, shkalle, shpues elektrikë etj

**Kërkesat e vlerësimit të funksionit:**

<u>Evidenca e performancës</u>: Evidenca se si kryhen aktivitetet, grumbullohen nëpërmjet vëzhgimit të kandidatit duke i bërë këto aktivitete (të përshkruara në funksion) në një situatë reale të punës. Kontrollimi i ambientit te punës /liste kontrolli.

<u>Evidenca e njohurive</u> : Test me shkrim, pyetje dhe përgjigje me gojë për të demonstruar që nxënësi i ka kuptuar kërkesat e punës .

**Funksioni 4: Kryen punime për hapjen e kanaleve dhe vrimave në NKUK**

Kjo njësi ka të bëjë me: Përzgjedhjen e resurseve për metodat e punës, hapjen e kanaleve dhe vrimave, respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit.

| **Aktivitetet kyçe**<br>**(+ rezultatet e punës)** | **Kriteret e performancës** | **Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin** | **Shkathtësitë** | **Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor** |
|---|---|---|---|---|
| Përzgjedhja e resurseve për metodat e punës. | Përzgjedhë veglat dhe pajisjet të sigurta të cilat plotësojnë kërkesat e sigurisë dhe shëndetit për hapjen e kanaleve; | Nxënësi /kandidati duhet të :<br>Dallon veglat, pajisjet e punës, ndërtimin e tyre dhe mirëmbajtjen e tyre,<br>Shpjegon punët ndërtimore,<br>Tregon teknikat dhe rregullat për hapjen e kanaleve dhe vrimave,<br>Tregon masat mbrojtëse të punës dhe sigurisë. | Aftësi të:<br>Përdorimit të veglave dhe pajisjeve të ndryshme për hapjen e kanaleve dhe vrimave,<br>Hapjes së kanale dhe vrima sipas kuotave të shënuara,<br>Zbatoj masat mbrojtëse të punës dhe sigurisë. | I përshtatshëm për punë ekipore,<br>Komunikativ,<br>Fleksibil,<br>Tolerant,<br>I arsyeshëm,<br>I vetëdijshëm për punën që kryen,<br>Njohja e gjuhëve të huaja. |
| Hapja e kanaleve, vrimave të ndryshme në vende të ndryshme të punës. | Punon në mënyrën e sigurt në të gjitha kohët në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet tjera relevante për sigurinë në punë dhe shëndetin;<br>Cakton kuotat për hapjen e kanaleve, vrimave;<br>Përdorë vegla të përshtatshme për hapjen e kanaleve dhe vrimave; | | | |
| Kontrolli i kualitetit të punës. | Zbaton normat dhe rregullat për ekzekutimin, hapjen e kanaleve dhe vrimave;<br>Kontrollon hapjen e kanaleve dhe vrimave sipas skicës së instalimit; | | | |
| Konsultim me personat adekuat (përgjegjësit). | Raporton ndonjë dëm apo ndonjë defekt para personit adekuat; | | | |
| Respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes se mjedisi. | Identifikon rreziqet e shëndetit;<br>Përdorë veshje korrekte dhe pajisje sigurimi të nevojshme për mbrojtjen nga rreziqet në përputhje me direktivën e mbrojtjes në punë;<br>Siguron hapësirën e punës;<br>Siguron pajisjet, veglat dhe materialet;<br>Kontribuon në evitimin e rreziqeve ndaj shëndetit;<br>Kontribuon në mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirën e punës; | | | |

**Kushtet e realizimit të funksionit: Kryerja e punimeve për hapjen e kanaleve dhe vrimave në NKUK I** referohet punimeve të cilat duhet të kryhen në përzgjedhjen e resurseve për metodat e punës në objektet private, veglave dhe pajisjeve që i referohen hapjes së kanaleve, vrimave të ndryshme në vende të ndryshme të punës. ,kontrolli i kualitetit të punës.dhe respektimin e masave mbrojtëse- I referohet punimeve të cilat duhet të kryhen në objektet private, shoqërore.

**Veglat dhe pajisjet e punës** për hapjen e kanaleve dhe vrimave: Dalta, çekani, nivelizues, metër, flex elektrikë dore, veshje pune, syza, dorëz pune, shkalle, shpues elektrikë, etj

**Kërkesat e vlerësimit të funksionit:**

Evidenca e performancës: Evidenca se si kryhen aktivitetet, grumbullohen nëpërmjet vëzhgimit të kandidatit duke i bërë këto aktivitete (të përshkruara në funksion) në një situatë reale të punës. Kontrollimi i ambientit të punës /listë kontrolli.

Evidenca e njohurive : -Test me shkrim, pyetje dhe përgjigje me gojë për të demonstruar që nxënësi i ka kuptuar kërkesat e punës, diskutim profesional.

**Funksioni 5: Kryerja e montimit te gypave dhe armaturave të ngrohjes e klimatizimit.**

Kjo funksion ka të bëjë me: Përzgjedhjen e resurseve për metodat e punës, kryerjen e punimeve për montimin e gypave dhe armaturave të rrjetit të brendshëm të ngrohjes qendrore, kontrollimin e rrjetit dhe funksionalitetin e rrjetit si dhe respektimit te mbrojtjes dhe sigurisë ne punë.

| **Aktivitetet kyçe**<br>**(+ rezultatet e punës)** | **Kriteret e performancës** | **Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin** | **Shkathtësitë** | **Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor** |
|---|---|---|---|---|
| Përzgjedhja e resurseve për metodat e punës. | Përzgjedh veglat dhe pajisjet të sigurta të cilat plotësojnë kërkesat e sigurisë dhe shëndetit;<br>Punon në mënyrë të sigurt sipas rregullores dhe udhëzimeve zyrtare për sigurinë në punë dhe shëndetin; | Nxënësi /kandidati duhet të :<br>Tregon llojet e gypave që përdoren në rrjetin e brendshëm të furnizimit,<br>Identifikon të gjitha llojet e rakorderive për të gjitha llojet e gypave,<br>Përshkruan të gjitha proceset dhe mënyrat e bashkimit të gypave me armaturat përkatëse,<br>Numëron të gjitha llojet e armaturave,<br>Tregon teknikat, mënyrat e montimit të tyre dhe kushtet e montimit dhe riparimit të tyre,<br>Shpjegon masat mbrojtëse dhe sigurinë në punë. | Aftësi të:<br>Përdorimit të veglave dhe pajisjeve në varësi të kërkesave,<br>Montimit të gypave të ndryshme dhe elementeve duke përdorur metoda të punës që i përgjigjen kërkesave të klientit,industrisë,<br>Montimit të armaturave sipas standardeve të kërkuara,<br>Kontrollon dhe teston rrjetin e instaluar,<br>Zbaton masat mbrojtëse dhe siguris në punë. | I përshtatshëm për punë ekipore,<br>Komunikativ,<br>Fleksibil,<br>Tolerant,<br>I arsyeshëm,<br>I vetëdijshëm për punën që kryen,<br>Njohja e gjuhëve të huaja,<br>Shkathtësi të mira në komunikim në gjuhen e profesionit dhe zyrtare me klient për planin e instalimit. |
| Kryen punime për montimin e gypave të bakrit, çelikut dhe plastikës. | Pozicionon, monton dhe lidh komponentët për t'ju përgjigjur kërkesave për dizajnimin e sistemit;<br>Shtrinë dhe përgatitë punën me gypa;<br>Lidhë komponentët me shërbimet e sistemit duke përdor metodat që përputhen me kërkesat e industrisë /klientit;<br>Bën procese të instalimit duke zvogëluar dëmet klientëve dhe mjedisit të punës;<br>Raporton për çfarëdo kushte që ndikojnë në progresin e instalimit nga personat relevant;<br>Korrigjon masat gjatë procesit të instalimit dhe skicën e vizatimit nëse është e nevojshme; | | | |
| Montimi i armaturave. | Identifikon armaturat në përgjithësi;<br>Monton armaturat matëse;<br>Monton armaturat siguruese;<br>Monton armaturat mbyllëse dhe lëshuese; | | | |
| Kontrollimi i rrjetit dhe funksionaliteti i tij. | Kontrollon dimensionet, masat dhe korrigjon pozicionet e komponentëve të sistemit;<br>Përdoron i teste pa zë për të konfirmuar integritetin e sistemit të instaluar; | | | |
| | Identifikon rreziqet e shëndetit; | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes se mjedisi. | Përdorë veshje korrekte dhe pajisje sigurimi të nevojshme për mbrojtjen nga rreziqet në përputhje me direktivën e mbrojtjes në punë;<br>Siguron hapësirën e punës;<br>Siguron pajisjet , veglat dhe materialet;<br>Kontribuon në evitimin e rreziqeve ndaj shëndetit;<br>Kontribuon në mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirën e punës; | | | |

**Kushtet e realizimit të funksionit:**

**Kryerja e montimit te gypave dhe armaturave të ngrohjes e klimatizimit** referohet mënyrës së montimit ë gypave, kushteve teknike të punës në proceset dhe mënyrat e bashkimit të gypave me rakorderit përkatëse si lidhjen e gypave te bakrit, alumino plastit, PE, etj me rakorderi dhe me ngjitje, lidhjen e gypave të çelikut me saldim, lidhjen e gypave plastike me ngrohje, lidhjen e gypave pvc me ngjitje, lidhjen e gypave të bakrit me ngjitje me kallaj, lidhjen e gypave aluminoplastikë me presim, mënyrat dhe përcaktimi i veglës për lirim ose shtrëngim, izolimin e gypave, fiksimin dhe shtrimin e gypave në mur dhe në dysheme.

Kryej testimin e rrjetit që ka ndërtuar për të përcaktuar dhe shmangur defektet e mundshme. Respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes se mjedisit.

**Veglat dhe pajisjet: I** referohet veglave për shtrëngim dhe mbajtje, veglat për matje dhe kontroll, veglat dhe pajisjet për punime axhusterie, veglat për saldim dhe ngjitje, nivelizues, metër, flex elektrikë dore, veshje pune, syza, dorëz pune, shkalle, shpues elektrikë, veglat dhe pajisjet tjera ndihmese.

**Kërkesat e vlerësimit të funksionit:**

<u>Evidenca e performancës</u>: Evidenca se si kryhen aktivitetet, grumbullohen nëpërmjet vëzhgimit të kandidatit duke i bërë këto aktivitete (të përshkruara në funksion) në një situatë reale të punës. Kontrollimi i ambientit te punës /liste kontrolli.

<u>Evidenca e njohurive</u> : Test me shkrim, pyetje dhe përgjigje me gojë për të demonstruar që nxënësi i ka kuptuar kërkesat e punës ,diskutim profesional.

**Funksioni 6: Kryerja e montimit te gypave dhe armaturave të ujësjellësit e kanalizimit.**

Kjo funksion ka të bëjë me : Përzgjedhjen e resurseve për metodat e punës , kryerjen punimeve për montimin e gypave të rrjetit të brendshëm të ujësjellësit, kontrollimin e rrjetit dhe funksionalitetin e rrjetit. respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes se mjedisi.

| **Aktivitetet kyçe**<br>**(+ rezultatet e punës)** | **Kriteret e performancës** | **Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin** | **Shkathtësitë** | **Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor** |
|---|---|---|---|---|
| Përzgjedhja e resurseve për metodat e punës. | Përzgjedh veglat dhe pajisjet të sigurta të cilat plotësojnë kërkesat e sigurisë dhe shëndetit;<br>Punon në mënyrë të sigurt sipas rregullores dhe udhëzimeve zyrtare për sigurinë në punë dhe shëndetin; | Nxënësi /kandidati duhet të :<br>Klasifikon llojet e gypave qe përdoren në rrjetin e brendshëm të furnizimit.<br>Identifikon të gjitha llojet e rakorderive për të gjitha lloje të gypave<br>Tregon të gjitha teknikat dhe proceset të bashkimit të gypave me rakorderi përkatëse<br>Tregon të gjitha mënyrat e montimit të tyre dhe kushtet e montimit dhe riparimit të tyre . | Aftësi për të:<br>Përdor veglave dhe pajisjeve në varësi të kërkesave.<br>Instalon sisteme të rrjetit të ujësjellësit dhe elementeve duke përdorur metoda të punës që i përgjigjen kërkesave të klientit /industrisë<br>Montuar armaturat | I përshtatshëm për punë ekipore<br>Komunikativ<br>Fleksibil<br>Tolerant<br>I arsyeshëm<br>I vetëdijshëm për punën që kryen<br>Njohja e gjuhëve të huaja<br>Shkathtësi të mira ne komunikim ne gjuhen zyrtare me klient për planin e instalimit . |
| Kryen punime për montimin e gypave të çelikut dhe plastikës. | Pozicionon, monton dhe lidhë komponentët për t'ju përgjigjur kërkesave të dizajnimit të sistemit;<br>Shtrinë dhe përgatitë punën me gypa;<br>Lidhe komponentët me shërbimet e sistemit duke përdor metodat që përputhen me kërkesat e industrisë /klientit;<br>Bën procese të instalimit duke zvogëluar dëmet klientëve dhe mjedisit të punës;<br>Raporton çfarëdo kushte që ndikojnë në progresin e instalimit nga personat relevant;<br>Korrigjon masat gjatë procesit të instalimit dhe skicën e vizatimit nëse është e nevojshme; | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Montimi i gypave për drenazhim.<br><br>Montimi i armaturave. | Shtrinë dhe përgatitë punën me gypa;<br>Bën procese të instalimit duke zvogëluar dëmet klientëve dhe mjedisit të punës;<br>Raporton çfarëdo kushte që ndikojnë në progresin e instalimit nga personat relevant;<br>Identifikon armaturat në përgjithësi;<br>Monton armaturat matëse;<br>Monton armaturat siguruese;<br>Monton armaturat mbyllëse dhe lëshuese; | Shpjegon masat mbrojtëse dhe sigurinë në punë | Kontrolluar testuar rrjetin e instaluar<br>Zbatuar masat mbrojtëse dhe sigurinë në punë | |
| Kontrollimi i rrjetit dhe funksionaliteti i tij. | Kontrollon dimensionet, masat dhe korrigjon pozicionet e komponentëve të sistemit;<br>Përdorimi i testeve pa zë për të konfirmuar integritetin e sistemit të instaluar; | | | |
| Respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes në mjedis. | Identifikon rreziqet e shëndetit;<br>Përdorë veshje korrekte dhe pajisje sigurimi të nevojshme për mbrojtjen nga rreziqet në përputhje me direktivat e mbrojtjes në punë;<br>Siguron hapësirën e punës;<br>Siguron pajisjet, veglat dhe materialet;<br>Kontribuon në evitimin e rreziqeve ndaj shëndetit;<br>Kontribuon në mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirën e punës; | | | |

**Kushtet e realizimit të funksionit:**

**Kryen punime për montimin e gypave të rrjetit të brendshëm të ujësjellësit e kanalizimit:** I referohet mënyrës së montimit të gypave, kushteve teknike të punës në proceset dhe mënyrat e bashkimit të gypave me rakorderire përkatëse si lidhjen e gypave të zinkuar me filetë , lidhjen e gypave të çelikut me saldim, lidhjen e gypave plastike me ngrohje, lidhjen e gypave pvc me ngjitje, lidhjen e gypave alumino-plastike me presim, mënyrat dhe përcaktimi i veglës për lirim ose shtrëngim, izolimin e gypave, fiksimin dhe shtrëngimin e gypave në mur, vendosjen e gypave për drenazhim. Kryerjes së testimit të rrjetit që ka ndërtuar për të përcaktuar dhe shmangur defektet e mundshme. Respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit.

**Veglat dhe pajisjet:** I referohet veglave për shtrëngim dhe mbajtje, veglat për matje dhe kontroll, veglat dhe pajisjet për punime axhusterie, veglat për saldim dhe ngjitje, nivelizues, metër, flex elektrikë dore, veshje pune, syza, dorëz pune, shkalle, burgi fletuese, etj veglat dhe pajisjet tjera ndihmese.

**Kërkesat e vlerësimit**

Evidenca e performancës: Evidenca se si kryhen aktivitetet, grumbullohen nëpërmjet vëzhgimit të kandidatit duke i bërë këto aktivitete (të përshkruara në funksion) në një situatë reale të punës. Kontrollimi i ambientit të punës /listë kontrolli.

Evidenca e njohurive : Test me shkrim, pyetje dhe përgjigje me gojë për të demonstruar që nxënësi i ka kuptuar kërkesat e punës ,diskutim profesional.

**Funksioni 7: Montimi i trupave ngrohës**

Ky funksion është për qartësimin e llojet e punës që duhet të kryhet dhe të përgatisë të gjitha burimet që lidhen me kryerjen e punimeve në montimin e trupave ngrohës.

| **Aktivitetet kyçe**<br>**(+ rezultatet e punës)** | **Kriteret e performancës** | **Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin** | **Shkathtësitë** | **Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor** |
|---|---|---|---|---|
| Përzgjedhjen e resurseve për metodën e punës. | Përzgjedh veglat dhe pajisjet të sigurta të cilat plotësojnë kërkesat e sigurisë dhe shëndetit;<br>Punon në mënyrë të sigurt sipas rregullores dhe udhëzimeve zyrtare për sigurinë në punë dhe shëndetin; | Nxënësi /kandidati duhet të :<br>Shpjegon ndërtimin dhe përdorimin e veglave për montimin e trupave ngrohës,<br>Identifikon dimensionet standarde të trupave ngrohës, të nevojshme për montim,<br>Tregon teknikën e montimit të trupave ngrohës,<br>Tregon funksionin e valvulave të radiatorëve<br>Shpjegon mënyrën e testimit të trupave ngrohës,<br>Shpjegon masat mbrojtëse dhe sigurinë në punë. | Aftësi për të:<br>Përdor vegla dhe pajisje në varësi të kërkesave,<br>Monton trupat ngrohës dhe elementeve përcjellëse të tyre duke përdorur metoda të punës që i përgjigjen kërkesave të klientit /industrisë,<br>Kontrolluar dhe testuar radiatorët,<br>Respektuar masat mbrojtëse dhe të sigurisë në punë. | I përshtatshëm për punë ekipore,<br>Komunikativ,<br>Fleksibil,<br>Tolerant,<br>I arsyeshëm,<br>I vetëdijshëm për punën që kryen,<br>Njohja e gjuhëve të huaja,<br>Shkathtësi te mira ne komunikim në gjuhen e profesionit dhe zyrtare me klient për planin e instalimit. |
